

Çfarë të drejta kam si flijesë e një vepre penale?

Askush nuk është i përgatitur të bëhet flijesë e një vepre penale. Nuk është me rëndësi se rrjedh nga vjedhje xhepi, nga një dëmtim trupi ose nga një vepre tjetër penale: Nga vepra penale je i lënduar ose i shqetsuar dhe pastaj shpesh nuk din çfarë të bëjsh. Kjo fletë informacioni dëshiron të jape një pasqyrë mbi mundësitë e marrjes së ndihmës dhe tju informoje se çfarë të drejta keni.

Kush mund të më ndihmoje?

Këshillim dhe ndihmë ofrojnë organizata ndihmëse për flijesa. Në këto zyra këshilluese punojnë gra dhe burra enkas të shkolluar për këto punë që kanë shumë eksperiencë me njerëz në situatën tuaj që Juve ju dëgjojnë dhe ndihmojnë. Ato janë në gjendje Juve edhe ndihmë më të thellë tju ofrojnë sipas rëndësisë së rastit, si për shembull ndihmë psikologjik dhe terapeut.

Një vështrim mbi mundësitë se kuajt mund ti ndrejtoheni e gjejni këtu: (Website BMJV, QR-Code). Përndryshe mund juve tju ndihmoje edhe çdo komisariat policor ose në dataportal online për të prekurit nga veprat penale (www.odabs.org / <http://www.odabs.org/>).

Si mund të denoncoj një vepër penale dhe çfarë ndodhën pastaj?

Nëse ju dëshironi të denonconi një vepër penale, atëherë Ju mund të drejtoheni në çdo komisariat policor. Nëse ju keni shtruar një denoncim penal, atëherë Ju nuk mund më aq kollaj të tërhiqeni prap, sepse organet hetuese (policia dhe prokuroria) janë të detyruar gati çdo vepër penale të denoncuar të ndjekin.

Vetëm në disa raste të veprave penale me peshë të vogël (si për shembull fyrije ose dëmtim të sendeve) ka flijesa mundësi të vendose se a do te ndjekët vepra penale. Për këtë arsye këto lloj delikte quhen delikte me kërkesë: Ndjekja penale ushtrohet vetëm pas kërkesës, domethanë vetëm atëherë kur Ju si flijesë e veprës penale këtë e dëshironi. Këtë kërkesë Ju duhet mbrenda tre muajsh të shtroni pasi Ju për veprën dhe personin e vepruesit keni marrur vesh.

Çfarë ndodh nëse unë nuk e kuptoj gjuhën gjermane ose kam vështërsi ta kuptoj?

Nuk prish punë. Nëse Ju dëshironi të shtroni një denoncim atëherë Juve do tju ndihmohet. Nëse Ju merrni në pyetje si dëshmitare ose dëshmitarë, atëherë Ju keni të drejtën që të thirret edhe një përkthyes.

Çfarë informacione mbi proçedurën penale mund përfitoj?

Nëse Ju jeni bërë flijesë e një veprë penale, atëherë Ju nuk merreni gjithmonë automatikisht informacione mbi proçedurën penale. Ju duhet më së miri ke policia të tregoni se çfarë informacione Ju dëshironi të dini. Nëse Ju e shprehni këtë dëshirë, atëherë Juve ju informojnë mbi këto si vijon:

- Ju e pranoni një vërtetim të shkurtër me shkrim mbi denoncimin tuaj penal
- Juve ju bëhet e ditur kur prokuroria e mbyll proçedurën, domethanë kur nuk ngrihet akuza para gjykatë.
- Ju informoheni se kur dhe ku do të mbahet gjykimi dhe për çfarë ngarkohet i akuzuari.
- Juve ju tregohet rezultati e proçedurës gjygsore, domethanë pamvarrur se a do të ketë vendim lirues ose dënues ose a është mbyllur proçedura.
- Juve ju jepet informacioni se i pandehuri ose i dënuari a qëndron në burg.
- Juve ju tregohet a i ndalohet të dënuarit të marre me juve kontakt.

Mbi këtë ju keni mundësi në raste të veçanta të kërkoni që tju jepen informacione ose kopje nga dosja. Kjo mund për shembull pas një aksidenti rrugor të jetë një skicë e ndeshjes, që Juve ju duhet për të kërkuar dëmshpërbim ose para për dhimbjet tuaja. Nëse Ju nuk e keni të drejtën e akuzës ansore (shih më poshtë për akuzën ansore), atëherë Ju duhet kërkesën ta arsyetoni, kjo domethanë se Ju duhet të sqaroni pse Juve ju duhen këto informacione nga dosja. Përrjashtime janë në raste të veçante të mundshme.

Dëshmia Juaj si dëshmitare ose dëshmitarë

Nëse Ju jeni bërë një flijesë e një veprë penale, atëherë Ju si dëshmitare ose dëshmitarë për proçedurën jeni shumë i rëndësishëm. Normalisht dëshminë Ju e jepni në polici. Në raste të shumta Ju duhet më vonë edhe në gjykatë të dëshmoheni. Vetëm në raste të rralla mund për shembull, kur Ju jeni me personin e dyshuar i martuar ose familjar, atëherë Ju keni mundësi mos dëshmoheni, d.th. Ju nuk duhet të thoni diçka.

Por Ju duhet në pyetmarrjen tuaj të thoni emrin dhe adresën tuaj. Mund të bëhet një përrjashtim, kur ekziston një situatë e posaçme e rrezikut. Kjo mund për shembull të jetë në ato raste kur dikush juve ju kërcnohet me dhunë, sepse Ju doni të japni deklaratë. Atëherë Ju nuk jeni i detyruar të japni adresën tuaj. Në këto raste Ju keni mundësi të japni një adresë tjetër ku mund Juve tju kontaktojnë. Kjo mund për shembull edhe një organizatë ndihmëse për flijesa të jetë, me që Ju jeni në kontakt.

Të dëshmohehi si dëshmitare ose dëshmitarë për Ju me siguri është një situatë e jashtëzakonshme që është shumë ngarkuese. Për këtë arsye Ju keni të drejt në pyetmarrje të merrni dikënd me vete që ju përcjell. Ky person mund të jetë një person familjar ose një shoqe ose shkok. Ky person ka të drejt të jetë i pranishëm në pyetmarrje dhe të përjashtohet vetëm në raste të posaçme. Natyrsht Ju mund edhe nga një avokate ose avokat të përcillen. Në raste të posaçme Ju mund edhe të pëcillen nga një avokate ose avokat me bartjen e pagesës nga shteti. Nëse Ju e keni mendimin se Juve në pyetmarrje, ndash nga policia, prokuroria ose nga gjykata, ju duhet një person përcjellës, atëherë pyetni paraprakisht personin që don të zhvilloje pyetmarrjen.

Nëse fëmijë ose të mitur janë bërë flijesa të dhunës ose veprave penale seksuale atëherë ka mundësi të përcjelljes dhe kujdesjes profesionale gjatë gjith procesurës, kjo është e ashtuquajtura përcjellja procesuale dhe psikosociale. Në raste të veçanta mund edhe flijesa të rritura të veprimeve penale të rënda të dhunës ose seksuale të kenë nevojë për një përcjellje të tillë dhe edhe të marrin atë. Përcjellja psikosociale procesuale është në rastet kur gjykata e jep pëlqimin e vetë pa para për flijesat. Pyetni te policia ose në organizatat për flijesat. Ato janë në gjendje Juve informacione më të hollsishe tu japin. Në internet Ju keni mundësi gjithashtu informacione të gjeni mbi përcjelljen procesuale psikosociale nën www.mbjv.de/opferschutz dhe atje nën rubrikën „psychosoziale Prozessbegleitung“.

A kam mundesi ti bashkangjitem procesurës penale si paditëse ose paditës anorë?
Nëse Ju jeni flijesë e një veprave penale, atëherë Ju keni mundësi në procesurë si paditëse ose paditës anorë të veproni. I përkasin për shembull përdhunimi, keqtrajtimi seksual, tentativë e vrasjes ose një vepër që ka shkaktuar vdekjen e një personi të afërm. Në këto raste Ju keni të drejta të posaçme. Për shembull, Ju keni mundësi, ndryshe nga dëshmitarët, gjithmonë të marrni pjesë në procesurën gjyqsore.

Kush ma paguan avokatën ose avokatin?

Në Ju marrni ndihmën e një avokati, atëherë Juve ju shkaktohen shpenzime. Nëse i akuzuari dënohet, atëherë ai dueht shpenzimet e avokatit tuaj dueht ti barte. Por nuk janë të gjith tëakuzuarit në gjendje ti bartin shpenzimet. Për këtë arsye mund të ndodhe që Ju duhet shpenzimet tuaja vetë ti bartni. Në raste të posaçme Ju keni mundësi ndaj gjykatës të kërkoni që sheti avokatin ta paguaje. Kjo vjen parasysh për shembull në raste në vepra të rënda të trupit ose në vepra penale seksuale ose kur persona familjar, si për shembull fëmijë, prindë ose bashkshortja ose bashkshorti nëpëmjet një veprave penale e kanë humbur jetën. Në këto raste nuk mvarret nga pasuria Juaj.

Edhe në raste tjera Ju keni mundësi në gjykatë të kërkonti financimin e këshillimit avokatore. Kjo mund të jetë në rastin kur të dhënta tuaja mujore janë shumë të ulta dhe Ju keni të drejtën procedurës si paditëse ose paditës ansorë ti bashkangjiteni.

Dëmshpërblim

Juve ju është shkaktuar nga një veprë penale një dëm ose Ju dëshironi dëmshpërblim? Ju dëshironi menjëherë në procedurën penale ta kërkoni? Kjo është normalisht e mundshme (e ashtuquajtura procedura e adhezionit -Adhäsionsverfahren-). Por për këtë Ju duhet të shtroni një kërkesë. Këtë mund ta bëjni qysh atëherë kur Ju denonconi veprën penale.

Natyrisht Ju e keni edhe rrugën e lirë dëmshpërblim në një procedurë tjetër të kërkonti, domethanë jo para gjykatës penale, por para asaj civile. Edhe këtu Ju keni mundësi të kërkonti ndihmë financiarë për këshillimin e një avokati, nëse të ardhurat tuaja janë shumë të ulta.

Çfarë të drejta tjera kam pëndryshe?

Ju jeni dëmtuar në shëndet nga një veprë penale me dhunë? Atëherë Ju mund ndihmë financiar sipas ligjit për shpërblimin e flijësave, nëse i përket shërimit mjekësor ose psikoterapeut, shërbimit me mjete ndihmëse (për shembull ndihmë për të ecur, karrige me rrota) ose rendiment pensionar (për shembull për kompenzimin e humbjeve të të ardhurave) të kërkonti. Një kërkesë të shkurtër mund të shtroni qysh ke policia.

Nëse jeni një flijesë e një sulmimi ekstremist ose veprave penale terroriste, atëherë mund të kërkonti ndihmë financiar ke zyra federale e drejtësisë (Bundesamt für Justiz). Atje për gjithçka rreth kushteve dhe për procedurën do të informoheni (www.bundesjustizamt.de/ (fjala kërkuese: Härteleistungen/Opferhilfe).

Si flijesë e dhunës shtëpiake ndoshta Ju keni edhe më shumë të drejta sipas ligjit për mbrojtjen kundër dhunës (Gewaltschutzgesetz). Për shembull Ju keni mundësi në gjykatën familjare të kërkonti që vepruesit ose veprueses ti ndalohej që të marre kontakt me Juve. Gjykata mund Juve nën plotësimin e disa kushteve tju lejoje që Ju shtëpinë/banesën e përbashkët me vepruesin ose vepruesën ta përdoreni vetëm. Për kërkesat e nevojshme mund ti drejtoheni gjykatës së shkallës së parë (Amtsgericht) me shkrim ose personalisht me gojë. Ju nuk jeni e/i detyruar të mbroheni nga një avokate ose avokat.

Çfarë është kompenzimi ndërmjet vepruesit dhe flijesës (Täter-Opfer-Ausgleich)?

Kështu titullohet një procedurë që është sidomos paraparë që flijesës e një veprë penale ti ndihmoje padrejtësinë e përjetuar të përballoje. Ndryshe nga procedura penale normale këtu veprusi ose vepruesja duhet konkretisht dhe direkt të merret me me pasojat që i ka shkaktuar nëpërmjet veprimit tek flijesa. Kjo mund të përkase dëmin material që është shkaktuar tek flijesa nëpërmjet veprimit penal ose dëmtimet shpirtërore, fyerjet personale dhe frika që është shkaktuar nga vepra. Një kompenzim ndërmjet vepruesit dhe flijesës asnjëherë nuk bëhet pa pëlqimin e flijesës, edhe atëherë vetëm nëse vepruesi ose vepruesja seriozisht është gati përgjegjës për veprimin të pranoje. Në raste të përshtatshme mund një kompenzim ndërmjet vepruesit dhe flijesës zgjidhjes të kapëcimit të konfliktit të flijesës ose për rivendosjen e qetësisë ligjore të ndihmoje. Shpesh për këtë arsye vetë nga prokuroria ose policia kjo procedurë rekomandohet. Normalisht nuk i takon procedurës penale dhe për këtë arsye jashtë procedurës penale zbatohet. Për këtë ka zyra dhe organizata të posaçme që kanë ndërmjetësuese ose ndërmjetësues të shkolluar.

Informacione tjera mbi kompenzimin ndërmjet vepruesit dhe flijesës dhe mbi organizatat, që mund të zhvillojnë në afësinë tuaj i gjejni në internet në shembull nën: <http://www.toa-servicebuero.de/konfliktschlichter> ose edhe nën <http://bag-toa.de/>.

Broshura dhe linke të mëtejshme

Informacione rreth mbrojtjen e flijesave gjeni edhe në homepage të Ministrisë së Drejtësisë dhe Mbrojtje për Konsumatorë (BMJV). Atje gjeni edhe linke në faqet e internetit e landeve federale (me informacione mbi organizatat ndihmëse për flijesat në vend) dhe linke mbi databank-online për personat të prekur penalisht (ODABS (duhet njëherë të lirohet): Codi QR ose <http://www.bmjv.de/opferschutz>

Informacione tjera ndihmëse Ju gjeni në këto fletëza:

- „Opferfibel“
- „Ich habe Rechte“ (Unë kam të drejta)
- „Mehr Schutz bei häuslicher Gewalt“ (Më shumë mbrojtje në dhunë shtëpiake)
- „Beratungs- oder Prozesskostenhilfe“ (Ndihmë këshilimi ose ndihmë për zhvillimin e procesit)

nën www.bmjv.de/publikationen)

- „Hilfe für Opfer von Gewalttaten“ (Ndihmë për flijesa nga vepra penale)
- www.bmas.de/ (fjala kërkuese: Hilfe für Opfer von Gewaltdaten)

Porosia e publikacioneve

Internet: www.bmjv.de

Nëpërmjet postës: Publikationsversand der Bundesregierung,

Postfach 48 10 09, 18132 Rostock

Telefon: (030) 18 272 272 1 Faks: (030) 18 10 272 272 1